



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të:

AC-I-15-0160-A0001

Paditësi

E.S. Kamenicë, i përfaqësuar nga avokati

Kundër

E paditura/ankuesja

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga "Agim Ramadani", nr. 23, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues Hajrie Shala dhe Sabri Halili gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve, të paraqitura ndaj Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar, C-IV-13-0706, të datës 21 Korrik 2015, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 12/09/2019 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1.** Ankesa e AKP-së, refuzohet si e pabazuar.
- 2.** Vërtetohet, Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar, C-IV-13-0706, i datës 21 korrik 2015. Ndryshohet pika -II- e dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar dhe fjalia, Obligohet AKP-ja–Autoriteti i

Likuidimit i NSH-së, "X" është ndryshuar me fjalinë, e paditura – AKP-ja-Autoriteti i Likuidimit është e obliguar që ta marr në konsideratë padinë e paditësit, **E.S.** për pagat e papaguara në shumë prej 3.538,79 Euro, në procedurën e likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Më 13 Maj 2013 ankuesi parashtroi ankesë në Dhomën së Posaçme, kundër vendimit të AKP-së, Autoritetit të Likuidimit nr. GJI066-0073, të datës 05 Prill 2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për pagat e pa paguara për periudhën dhjetor 2006 - dhjetor 2007, në shumë prej 3.896.81 euro, nga NSH "X", në Kamenicë (në likuidim). Ankesës ia kishte bashkangjitur, një kopje të vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, Vendimin nr. GJI066-0073, të datës 05 Prill 2013, me të cilin ishte refuzuar kërkesa si e pavlefshme, njoftimin e AKP-së të datës 25 janar 2011, me të cilin është njoftuar për fillimin e likuidimit të NSH-së, një regjistër të nënshkruar nga punëtorët e NSH-së, të cilët pranuan njoftimet mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, si dhe raportet mujore të punës pranë NSH-së, për muajin dhjetor 2006, dhe muajt janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor, dhe dhjetor 2007. Në Vendimin e marrë nga AL, në paragrafin 2 të këtij vendimi thuhet se, "parashtruesi paraqiti kërkesën e tij më 28 shkurt 2011, që është brenda afatit për dorëzimin e kërkesave". Nga Dhoma e Posaçme ka kërkuar që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar, dhe të shfuqizohet vendimi i atakuar e atij ti njihet e drejta në kompensimin e pagave të pa paguara.

Me 22 korrik 2013, Kolegji i Specializuar ka urdhëruar ankuesin për plotësimin e disa kërkesave në drejtim të pranueshmerisë së ankesës. Urdhri u përmbush në tërësi nga ankuesi.

Më 14 nëntor 2013, Kolegji i Specializuar e dërgoi ankesën tek AKP-ja, e cila në mbrojtjen e saj të datës 18 dhjetor 2013, i propozoi Gjykatës që ankesën e ankuesit ta refuzojë si të pabazuar dhe ta vërtetojë (le në fuqi) vendimin e Autoritetit të Likuidimit. AKP në mbrojtjen e saj pohon se Autoriteti i Likuidimit ka kryerë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike (për çka nuk ekziston ndonjë mosmarrëveshje në mes palëve) si dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë

III

dispozitat ligjore. Kërkesa është refuzuar pasi ankuesi nuk ka ndërmarr asnjë veprim ligjor pranë ndonjë gjykate për të ndërprerë parashkrimin. Neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (i aplikueshëm) parasheh që pagesa e pagës apo secila kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë parashkruar për tre vjet. Në rastin konkret kërkesa ka të bëjë me pagat e papaguara nga Dhjetori 2006 që është parashkruar në dhjetor 2009. AKP më tej pohon se mosnjohja nuk është justifikim për të shmangur ligjin e zbatueshëm si dhe ligji për punën e bashkuar është ligj që ka qenë në fuqi me 22 mars 1989 dhe i njëjti është i zbatueshëm, andaj edhe propozon që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Më 16 janar 2014, Kolegji i Specializuar, mbrojtjen në ankesë e dërgoi te përfaqësuesi i ankuesit, i cili në përgjigjen e tij të datës 29 janar 2014 e kundërshtoi. E paditura i ka vënë në lajthim, i ka mbajtur të pafajshëm dhe nuk ka komunikuar me punëtorët edhe pse të gjithë dokumentacionin dhe arkivin e ndërmarrjes e ka në dispozicion të saj. Është vet e paditura ajo që i ka zvarrit procedurat e likuidimit. Përfaqësuesi i ankuesit më tej pohon se në rastin konkret referimi rreth parashkrimit, vendimi si dhe mbrojtja në ankesë e AKP-së janë në kundërshtim me ligjin dhe me vet veprimet e saj, andaj i propozon Gjykatës që të aprovon ankesën dhe të obligoj AKP-në për kompensimin e pagave për periudhën e cekur.

Më 7 Mars 2014, Kolegji i Specializuar, përgjigjen në mbrojtje e dërgoi për Kundërpërgjigje te AKP, e cila me 25 Mars 2014 e kundërshtoi. Sipas AKP-së, qëndrimi i ankuesit lidhur me aplikimin e dispozitave për parashkrim nuk është i drejtë. Neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar është dispozite e aplikueshme dhe e njëjta është aplikuar drejtë. Mbi bazën e argumenteve të cekura i propozon Gjykatës që ankesën ta refuzojë si të pabazuar dhe ta vërtetojë (lë në fuqi) vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Në mbështetje ka bashkangjitur ligjin Për Ndërmarrjet (GZ 77/1988).

Më 8 Korrik 2015, Kolegji i Specializuar e dërgoi listën e pagave të papaguara të NSH-së, tek palët për t'u njoftuar dhe deklaruar në lidhje me të në cilësi të provës.

E paditura në përgjigjen e saj të datës 10 korrik 2015 e kundërshtoi. Sipas AKP-së dokumenti në fjalë nuk është paraqitur nga palët në lëndën konkrete, andaj

AKP e ka të pamundur të shprehet në lidhje me vlerën e mundshme provuese të saj. AKP më tej pohon se edhe nëse dokumenti në fjalë të ishte paraqitur dhe administruar si provë në këtë çështje , ai nuk ka ndonjë efekt mbi zgjidhjen e saj.

Ankuesi (përfaqësuesi i tij) në përgjigjen e datës 13 korrik 2015, pohon se nuk ka vërejtje dhe se e përkrah qëndrimin e kolegjit të specializuar për vendosjen e lëndës përveç tjerash edhe për arsye se lista e bashkëngjitur e pagave të papaguara është përpiluar nga ana e personit përgjegjës për llogaritjen dhe ekzekutimin e pagave të NSH-së.

Më 21 korrik 2015, Kolegji i Specializuar kishte marrë Aktgjykimin C-IV-13-0706, me të cilin, aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa, dhe anulohet vendimi i AKP-së – Autoriteti i Likuidimit nr. GJI066-0073 i datës 05.04.2013, obligohet e paditura AKP që në emër të pagave të pa paguara ankuesit E.S. nga Kamenica, për periudhën kohore Dhjetor 2006- Dhjetor 2007 t'i paguaj shumën prej 3.538.79 euro në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi. Taksat gjyqësore në shumë prej 30 Euro caktohen për këtë procedure, obligohet e paditura AKP , ti kompensoi ankuesit shumën prej 25 euro, në emër të taksave gjyqësore të paguar nga ankuesi, dhe ti paguaj 5 euro në gjykatë në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, Kolegji i Specializuar konstaton se pas shqyrtimit të gjithanshëm të ankesës, të gjitha provave të bashkëngjitura dhe atyre të grumbulluara gjatë procedurës me shkrim në mes palëve, konstaton se kërkesa për pagat e pa paguara për periudhën kohore dhjetor 2006 - dhjetor 2007 në shumën prej 3.896.81 euro është e bazuar pjesërisht. Agjencia Kosovare e Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, gjatë vendosjes për kërkesën e ankuesit, kishte vendosur refuzimin e ankesës se ankuesit si të pavlefshme, me arsyetim se e njëjta ishte parashkruar pasi në pajtim me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar GZ nr.53/1976 (i aplikueshëm sipas Rregullores së UNMIK ut nr.1999/24) çdo pagesë e pagës apo kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë parashkruar për tre vjet.

Dhoma e Posaçme, ka konstatuar se e paditura gabimisht ka refuzuar kërkesën e ankuesit në rastin konkret për arsyet si në vijim:

Ankuesi ishte njëri nga punonjësit e NSH-së i cili me njoftimin e datës 13 Dhjetor 2007, lëshuar nga paraardhësja e të paditurës (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ose shkurt AKM) ishte njoftuar se si rezultat i vërtetimit nga Bordi i AKM-së të kontratës për shitjen e asetëve të NSH-së, punësimi përfundon menjëherë, dhe se njoftimi në fjalë përbente njoftim zyrtar. Për më tepër shumat ose pagesat e papaguara nga NSH-ja mbeten përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të njoftoheni kur të fillojnë këto procedura. Andaj ky njoftim përderisa ka parashikuar mundësinë e mbetjes borgj ndaj ankuesit dhe kur dihej se i njëjti figuronte në listën e pagave të papaguara me tepër mund të shihet si një bazë për ndërprerjen e afatit të parashkrimit se sa të kundërtën siç ka vendosur e paditura.

Kolegji konstaton se përfundimi i marrëdhënies se punës se ankuesit ishte bërë si rezultat i veprimit të AKP-së, me rastin e shitjes se asetëve të ndërmarrjeve, që është kompetencë e AKP-së, e paraparë me dispozitat e nenit 6 të Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. AKP-ja, duke e kryer shitjen e asetëve të ndërmarrjes së lartshënuar, ka bërë përfundimin e marrëdhënies së punës të punëtorëve të kësaj NSH-je.

Është e pabazuar dhe Kolegji nuk e aprovon pohimin e AKP-së të parashtruar në mbrojtje ndaj ankesës, se kërkesa është e parashkruar, sepse e njëjta nuk është dorëzuar në ndonjë gjykatë në afatin prej 3 viteve dhe me këtë referimi në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, nuk është i mundur pasi që me këtë rast ky Ligj nuk mund të zbatohet për faktin se kjo çështje është e rregulluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si Ligj i posaçëm (*lex specialis*).

Më 31 korrik 2015, AKP –Autoriteti i Likuidimit(AL) ka parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi, duke e kontestuar dispozitivin dhe arsyetimin e dhënë në këtë Aktgjykim. AL me shumë faqe në ankesë është marrë me "historikun procedural" të aktgjykimit të kundërshtuar. AL pretendon se në vendimmarrje gjykata ka përdorur dëshmi nga rastet tjera, pa ia mundësuar AL-së për ta kundërshtuar një dëshmi të tillë, duke iu referuar në këtë rast "listës së pagave të papaguara".

Sipas AL-së, një praktikë e tillë nuk është në përputhje me Ligjin 04/L-003 dhe Ligjin Nr.06/L-006 "Për Procedurën Kontestimore". Kolegji i Specializuar ka shkelur nenin 48 i Shtojcës së Ligjit 04/L-033. AL konsideron se në hapësirën

kohore ndërmjet tri viteve 13.12.2007 -13.12.2010, paditësi nuk ka parashtruar asnjë padi në DHPGJS për të kërkuar rrogat e tij (në bazë të nenit 4 të Rregullores 2002/13) dhe as e ka ndërprerë parashkrimin në ndonjë mënyrë tjetër kështu që kërkesat e tij ndaj NSH-së janë gjithsesi të parashkruara. Andaj kërkojmë nga Kolegji i Apelit që ta shfuqizojë Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar dhe të gjykojë meritat e rastit të refuzojë Ankesën e kërkuarit kundër Vendimit të AL, dhe të vërtetojë Vendimin e AL.

Më 08 Maj 2018, përfaqësuesi i Ankuesit ka pranuar Apelin e AKP-së kundër Aktgjykimit të Gjykatës C-IV-13-0706, të datës 21.07.2015. Përfaqësuesi i Ankuesit e përkrahë qëndrimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJSK, për vendosjen e lëndës përveç tjerash edhe për arsye se lista e pagave të papaguara të ish punëtorëve të kësaj ndërmarrje shoqërore është e përpiluar nga ana e personit përgjegjës të NSH "X", për llogaritjen dhe ekzekutimin e pagave por edhe të pagesave të tjera të kësaj ndërmarrje. Andaj kërkojmë nga Kolegji i Apelit që ta refuzojë Ankesën e të paditurës dhe ta lërë në fuqi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar me nr.C-IV-13-0706, dt.21.07.2015.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e pabazuar.

Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës sipas nenit 69.1 të Ligjit nr.06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit .

Pretendimi ankimor i AL-së është se, në vendimmarrje, gjykata ka përdorur dëshmi nga rastet tjera, pa ia mundësuar AL-së për ta kundërshtuar një dëshmi të tillë, duke iu referuar në këtë rast "listës së pagave të papaguara".

Kolegji i Apelit konstaton se një pretendim i këtillë nuk është i bazuar për faktin se listën e pagave të papaguara e ka vetë NSH-ja, ku AL është kompetent për të menaxhuar me të gjitha dokumentet dhe dëshmitë e mundshme, e nuk është një dokument të cilin e ka krijuar paditësi, apo personat e tretë.

VII

Pretendimi tjetër ankimor i AKP-së është se gjykata me aktgjykimin e kundërshtuar gabimisht ka vlerësuar se arsyetimi i AL nuk është i bazuar dhe kërkesa e paditësit nuk është parashkuar.

Me njoftimin e datës 13 dhjetor 2007, lëshuar nga paraardhësja e të paditurës (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ose shkurt AKM) ankuesi E.S. ishte njoftuar se si rezultat i vërtetimit nga Bordi i AKM-së të kontratës për shitjen e asetëve të NSH-së, punësimi përfundon menjëherë, dhe se njoftimi në fjalë përbënte njoftim zyrtar. Për me tepër shumat ose pagesat e papaguara nga NSH-ja mbeten përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të njoftoheni kur të fillojnë këto procedura. Andaj ky njoftim përderisa ka parashikuar mundësinë e mbetjes borgj ndaj ankuesit dhe kur dihej se i njëjti figuronte në listën e pagave të papaguara me tepër mund të shihet si një bazë për ndërprerjen e afatit të parashkrimit dhe tek paditësi ka krijuar pritshmëri të arsyeshëm se në momentin e fillimit të procedurës së likuidimit ai mund të parashtrojë kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara.

Ankuesi është njoftuar nga ana e AKP-së më 25 janar 2011 se likuidimi i NSH-së "X" në Kamenicë ka filluar nga data 31 dhjetor 2010, në bazë të vendimit të Bordit të AKP-së, dhe se nëse ankuesi ka ndonjë kërkesë ndaj ndërmarrjes së lartpërmendur kërkesën ta parashtroj te Agjencia – Autoriteti i Likuidimit gjer më 25 mars 2011. Stërzgjatja e procedurave nga e paditura prej momentit të privatizimit të NSH-së (13 dhjetor 2007) e gjerë në momentin e fillimit të likuidimit të NSH-së (31 dhjetor 2010), dhe pastaj nga kjo e fundit e deri në vendosjen rreth kërkesës së ankuesit nga e paditura, (vendimi i datës 5 prill 2013), gjithsej mbi 5 vite dhe refuzimi i kërkesës kreditore të ankuesit në emër të parashkrimit është plotësisht i gabuar. Pra e paditura ishte në dijeni që NSH-ja i kishte mbetur borgj ankuesit në emër të pagave të papaguara dhe me veprimet e saj (njoftimet e datave 13 dhjetor 2007 dhe 25 janar 2011) vetëm sa kishte njohur të drejtën e tij e cila do të mund të realizohej në kuadër të procedurave të likuidimit, e të cilave ju kishte përmbajtur ankuesi plotësisht. Kolegji i Apelit konstaton se në listën e NSH "X" në Kamenicë, për rrogat e mbetura e të pa paguara të punëtorëve ankuesi E.S. gjendet në numrin rendor 16 dhe atë për pagat nga muaji dhjetor 2006 - dhjetor 2007 në shumën prej 3.538.79 euro.

VIII

Kolegji i Apelit ka ndryshuar pikën -II- të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar në mënyrën e cekur në pikën e -II- të këtij Aktgjykimi, për shkak se kërkesa e aprovuar për paga në shumën e cekur duhet të trajtohet në procedurë të likuidimit sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj.

Bazuar në këto arsye që u cekën më lartë, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e AKP-së është e pabazuar, dhe rrjedhimisht vërtetohet Aktgjykimi i kundërshtuar i Kolegjit të Specializuar, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj konform nenit 9.10 të LDHPGJS-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat gjyqësore:

Meqenëse ankuesi ka paguar taksën gjyqësore për parashtrimin e ankesës në lartësi prej 100 euro, nuk ngarkohet me taksë.

U vendos nga Kolegji i Ankesave në DHPGJS, më 12/09/ 2018

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues

URDHËR PËR REGJISTRIN

Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim te:

- Palët
- Gjyqtari Kryesues i Kolegjit të Specializuar në lëndën C-IV-13-0706.

Gjyqtari kryesues , Ilmi Bajrami _____